

FJALA E DEPUTETIT PETRIT VASILI

E ENJTE 8 SHTATOR 2022

Zonja Kryetare, kam ngritur edhe herë të tjera çështjen që Rregullorja e Kuvendit kërkon që për çdo projektligj, akt normativ, në relacionin që e shoqëron, të ketë patjetër gjithçka ka ndodhur, si është reflektuar dhe cili ka qenë mendimi i pakicës në komision. Po marr si shembull vetëm njërin nga aktet e depozituara sot, ku i gjithë ky detyrim, që rrjedh nga neni 34 i Rregullores, pika 3, mbyllet vetëm më një fjalë. Gjatë diskutimit shumica e deputetëve mbështetin projektligjin, deputetët e opozitës u shprehën kundër. Rregullorja flet qartë që mendimi i tyre pasqyrohet në mënyrë të plotë, të përmbledhur, pra jepen elementet thelbësore.

Kjo ide që në komision nuk ka rëndësi se për çfarë flet opozita, nuk ka rëndësi se çfarë diskutohet debatohet dhe çfarë për është kundër dhe nuk reflektohet asnjëherë, po bëhet vijë. Në raste shumë të rralla ndodh që të pasqyrohet, kurse në mënyrë të vazhdueshme nuk pasqyrohet. Tani ky është debat parlamentar, nuk është debat i një partie, sepse, në rast se është debat i një partie, na tregoni që është i tillë dhe ndryshojmë të tërë Rregulloren dhe themi që këtu flet vetëm një parti, flet vetëm një që ka në krye partia e të tjera dhe kthehemi pastaj në atë idiotësinë që kishim 30 vjet më parë. Ky nuk është formalitet, por kushdo që vjen në sallë, kushdo që dëgjon dhe i merr këto dokumente, të cilat janë publike, tashmë kanë të drejtë të shikojnë se si është debatuar.

Nëse keni siklet se mendimet e kundërta janë shumë më të argumentuara dhe solide dhe i rrëzojnë nismat, ky është halli juaj, por ju nuk mund të dërrmoni çdo rregull dhe të thoni këtu se flasim vetëm ne. Mendimi se flasim vetëm ne, është kufiri i atyre që janë me probleme shumë të forta të personalitetit, me ata që nuk kanë si të afirmohen ndryshe, që e ndiejnë veten të poshtëruar dhe tremben nga çdo mendim ndryshe, ndaj respektojeni këtë normë të Rregullores të miratuar të gjithë së bashku dhe le të mos përsëritet më kurrë, nëse ju keni fuqi ta çoni deri në fund.